



avokim

shërbime

lobim

praktika

promovim

për interesa të komunave

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbajti Kuvendin Vjetor

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor ku kanë marrë pjesë delegatët nga Komunitet e Republikës së Kosovës dhe kryetarët e komunave. Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli hapi punimet e Kuvendit dhe paraqiti para të pranishmëve agjendën e punës së këtij takimi të organit më të lartë të Asociacionit të Komunave të Kosovës.



Drejtori AKK-së priti përfaqësuesit e SDC-së

Naim Ismajli: Fuqia politike e Kryetarëve të Komunave dhe Asociacioneve të tyre mund të bëjnë ndryshimin për të mirën e qytetarëve në Evropën Juglindore



Takimi i përbashkët mes Kolegjiut për Arsim dhe Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës



DISKUTIM MBI KONCEPT DOKUMENTIN PËR NDËRMARRJET PUBLIKE (fq.8)

.....

U themelua Kolegjiut për Prokurim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (fq.10)

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbajti Kuvendin Vjetor

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor ku kanë marrë pjesë delegatët nga Komunitet dhe Republikës së Kosovës dhe kryetarët e komunave. Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli hapi punimet e Kuvendit dhe paraqiti para të pranishmëve agjendën e punës së këtij takimi të organit më të lartë të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor i AKK-së sot debatoi për raportet vjetore të punës dhe atë financiar për vitin 2016 si dhe debatoi për agjendën legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017 dhe për çështjet tjera të lobimit në interes të Komunave të Kosovës.

Duke bërë paraqitjen e Raportit të Punës të AKK-së për vitin 2016, kryetari z.Naim Ismajli ndër të tjera tha se "sa i përket punës së AKK-së gjatë vitit 2016, në cilësinë e kryetarit, paraqes disa nga pikat kryesore të realizuara nga ana e strukturave të AKK-së në shërbim të interesave të Komunave, sepse më gjerësisht ato janë përshkruar në Draft – Raportin e Punës.

Edhe gjatë vitit 2016, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka punuar në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të komunave, ofrimit të shërbimeve të avancuara dhe përmirësimit të performancës së komunave, konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të reja të AKK-së dhe performancës së mirë financiare. Këto



aktivitete janë të bazuara në Planin Strategjik të AKK-së për vitin 2016-2020, Planin Vjetor 2016 si dhe në agjendën legjislative të Qeverisë dhe Parlamentit si dhe prioritetet e përcaktuara vjetore nga strukturat udhëheqëse.

AKK-ja është kyçur në agjendë legjislative të Qeverisë e Kuvendit të Kosovës duke qenë pjesë e grupeve punuese në shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve tjera ligjore në ekzekutiv dhe ka marrë pjesë në trupat e Parlamentit në takime dhe në disa dëgjime publike për të mbështetur qëndrimet dhe interesat e komunave të Republikës së Kosovës. AKK-ja ka adresuar rreth 85 kërkesa e rekomandime në nivelin qen-

dror dhe rezultati i inkorporimit të tyre në aktet ligjore dhe në interes të komunave shkon në 68 për qind. Si tregime të suksesshme të angazhimit të gjitha strukturave të AKK-së për të lobuar në interes të komunave gjatë vitit 2016 mund të veçohen: Projekt Ligji për Inspektime, Ligji i Trajtimeve e Ndërtimeve Pa Leje (ligji i ri), Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Katalogu i vendeve të punës, Projektligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të Komunës, Ligji për Kadastër, Ligji për Prokurimin Publik.

Bashkëpunimi me partnerë, AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, në realizimin e shumë

projekteve që kanë përfituar komunat qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj.

SDC-ja si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së ka dhënë kontribut thelbësor si mbështetje për AKK-në. Bashkëpunime me projekte të ngjashme janë implementuar me DEMOS, GIZ, NALAS, ACT/USAID-in, UNDP, UNICEF, Save the Children, Projekte të përkrahura nga Komisioni Evropian, OSBE-në etj. Po ashtu janë organizuar takimet “Miq të AKK-së” me partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale. Poashtu sa i përket ngritjes së kapaciteteve të Komunave, janë organizuar trajnimet në implementimin e legjislacionit të ri me zyrtarë të të gjitha niveleve të komunave – tha ndër të tjera kryetari Ismajli.

Delegatët e Kuvendit Vjetor të AKK-së, me shumicë votash miratuan raportet vjetore, ndërsa Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahim paraqiti në pika të shkurtra planin e punës për këtë vit dhe format e lobimit në interes të komunave të Kosovës.

Poashtu në këtë takim vjetor u debatuan edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale në Kosovë duke identifikuar disa nga problemet aktuale por me mjaft rëndësi si problemi i mbeturinave, nevoja për rritjen e shpenzimeve operative dhe disbalanci mes qeverisë qendrore dhe asaj lokale në këtë drejtim duke ditur se barra kryesore bie tek komunat, problemi i mirëmbajtjes së objekteve kolektive nëpër komuna etj.



Naim Ismajli: Fuqia politike e Kryetarëve të Komunave dhe Asociacioneve të tyre mund të bëjnë ndryshimin për të mirën e qytetarëve në Evropën Juglindore

Në Vjenë ka mbajtur punimet Asambleja e Përgjithshme e XII e Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) e cila poash-tu zhvillohet në kuadër të Konferencës vjetore të Ujërave të Danubit, duke sjellë së bashku Kryetarët e Komunave të Evropës Juglindore që të diskutojnë tema që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët e tyre.

Në hapje të këtij takimi, Kryetari i NALAS-it dhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli tha se “kaloj një vit që kur IAWD-ja dhe NALAS-i nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi dhe ishte kënaqësi të prisja z.Walter Kling në Kuvendin e Përgjithshëm të NALAS-it në Prishtinë. Sot jemi këtu, vetëm një vit që nga ajo kohë dhe me krenari mund të them se kemi qenë në gjendje të operacionalizojmë bashkëpunimin tonë në mënyrën më efektive. Gjatë këtyre dy ditëve, Udhëheqësia e Asociacioneve anëtare të NALAS-it do të marrë pjesë në debatet e Konferencës së Ujërave të Danubit. Së bashku me kolegët tanë nga kompanitë e shërbimeve dhe rrjetet e tyre do të eksplorojmë mënyra më efektive dhe efektive për modernizimin e shërbimeve tona të ujit. Pra, do të shikojmë praktikën e mira në financimin e investimeve për të përmirësuar infrastrukturën e trajtimit të ujit dhe mbeturinave. Përveç kësaj, do të nisim një përpjekje tjetër të përbashkët për të



ndërtuar një sistem rajonal të ndërtimit të kapaciteteve. Është fuqia e njohurive teknike e cila shtrihet në kompanitë tona të shërbimeve dhe fuqia politike e Kryetarëve të Komunave dhe Asociacioneve të tyre e të cilat kur kombinohen mund të bëjnë ndryshimin për të mirën e qytetarëve në Evropën Juglindore” – tha ndër të tjera kryetari z.Naim Ismajli

Në sesionin e pasdites, si pjesë e programit të konferencës, NALAS-i do të mbajë një sesion trajnimi mbi rolin e qeverive lokale në planifikimin e investimeve dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, ndërkohë që kryetarët dhe përfaqësuesit e AQL-ve do të marrin pjesë në seminare të ndryshme gjatë programit dyditor të konferencës.

Më 19 maj, Asambleja e Përgjithshme e NALAS-it u hap

nga Presidenti aktual i NALAS-it, z. Naim Ismajli, Znj. Breda Pecan, Zëvendës Presidente e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe Dr. Franz Schausberger, Këshilltar Special për Komisionerin Hahn.

Delegatët shqyrtojnë punën e NALAS-it në vitin 2016 dhe planin e punës për vitin 2017 dhe do të diskutojnë dhe miratojnë Planin e ri Strategjik të Rrjetit për periudhën 2018-2022. Dy dokumente politike të rëndësishme do të paraqiten nga Asambleja e Përgjithshme, një rreth Ballkanit Perëndimor në agjendën e zgjerimit të BE-së dhe Qeveritë Lokale dhe Asociacionet e tyre si aktorë kyç në procesin e integritit në BE dhe i dyti për t’iu përgjigjur nevojës për zhvillimin e kapaciteteve për sektorin e ujit dhe kanalizimeve në Evropën Juglindore.

Këtë vit Asambleja e Përgjithshme e XII e Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) zhvillohet në kuadër të Konferencës vjetore të Ujërave të Danubit (17-19 maj 2017, Vjenë, Austri), duke sjellë së bashku Kryetarët e Komunave të Evropës Juglindore të diskutojnë tema që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët e tyre.

Si pjesë e programit të konferencës, NALAS-i do të mbajë një sesion trajnimi mbi rolin e qeverive lokale në planifikimin e investimeve dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, ndërkohë që kryetarët dhe përfaqësuesit e AQL-ve do të marrin pjesë në seminare të ndryshme gjatë programit dy-ditor të konferencës.

Më 19 maj, Asambleja e Përgjithshme e NALAS-it do të hapet nga Presidenti aktual i NALAS-it, z. Naim Ismajli, Znj. Breda Pecan, Zëvendës Presidente e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe Dr. Franz Schausberger, Këshilltar

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit në agjendën e Kryetarëve të Komunave të Evropës Juglindore

Special për Komisionerin Hahn. Delegatët do të shqyrtojnë punën e NALAS-it në vitin 2016 dhe planin e punës për vitin 2017 dhe do të diskutojnë dhe miratojnë Planin e ri Strategjik të Rrjetit për periudhën 2018-2022. Dy dokumente politike të rëndësishme do të paraqiten nga Asambleja e Përgjithshme, një rreth Ballkanit Perëndimor në agjendën e zgjerimit të BE-së dhe Qeveritë Lokale dhe Asociacionet e tyre si aktorë kyç në procesin e integrimin në BE dhe i dyti për t'iu përgjigjur nevojës për zhvillimin e kapaciteteve për sektorin e ujit dhe kanalizimeve në Evropën Juglindore.

“BE-ja është për njerëzit, për njerëzit dhe përreth njerëzve. Vendndodhja ku njerëzit jetojnë, veprojnë, takohen dhe mbajnë lidhje direkte me qeverinë dhe administratën publike është niveli lokal! Për të qenë të suksesshëm nevojitet një qasje funksionale nga poshtë-lart që varet nga një koordinim efektiv dhe bashkëpunim në nivelin e qeverisjes lokale dhe qendrore” theksohet në Dokumentin Parimor të NALAS-it mbi Integrimin në BE. Dokumenti parimor paraqet disa propozime për lehtësimin e dialogut, siç janë: Komisioni i BE-së - Njësia teknike ose administrative për AQL-të dhe QL-të për t'iu drejtuar Grupit Punues të Parlamentit Evropian, Ditët e Bashkëpunimit të Ballkanit Perëndimor dhe sugjerimet për instrumentet mbështetëse të BE-së që do të rrisin përfshirjen e Qeverive lokale dhe asociacioneve të tyre.

Bazuar në sistemin e rotacionit të presidencës, z. Mico Micic, kryetar i komunës së Bijeljinës, Bosnje dhe Hercegovinë, pritet të marrë rolin e presidentit të NALAS-it, i cili do të udhëheqë Rrjetin në vitin e ardhshëm.



Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli mban fjalim në Grupin Punues për Ballkanin Perëndimor të Komiteteve dhe Rajoneve të Evropës

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës në përbërje z.Naim Ismajli – kryetar dhe z.Sazan Ibrahimimi Drejtor Ekzekutiv po marrin pjesë në takimin e Komiteteve dhe Rajoneve të Evropës – në Grupin Punues për Ballkanin Perëndimor. Takimin e ka hapur z.Franz SCHAUSBERGER – Kryesues i Grupit Punues për Ballkanin Perëndimor në Komitetin dhe Rajoneve të Evropës.



Ndërsa kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli, duke folur për ndërmarrësin, në fjalën e tij ndër të tjera tha se “si përfaqësues i Kosovës i përfshirë direkt në çështjet që kanë të bëjnë me nivelin lokal dhe duke pasur parasysh hulumtime të shumta të ndërmarrja, mund të thuhet që ndërmarrësit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e një kombi sepse ata startojnë biznese, ofrojnë punë dhe shfrytëzojnë burimet vendore për një rritje më të mirë socio-ekonomike. Ndërmarrësia është konsideruar si mekanizëm kryesor i zhvillimit ekonomik. Është përshkruar si motor që mundëson më së shumti rritjen e sektorit të biznesit si dhe si force kryesore në rritjen e mirëqenies sociale.

Qeveria e Kosovës njeht rëndësinë e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zhvillimin ekonomik të Kosovës, e sidomos rëndësinë e ndërmarrësisë dhe të gjenerimit të vendeve të punës për të rinjtë pasi që 99% të ndërmarrjeve në Kosovë janë të vogla dhe të mesme. Në vitin 2011 qeveria ka themeluar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) përmes Agjencisë KIESA që të merr përgjegjësinë për zhvillimin e Strategjisë 2012-2016 me vizionin 2020 (Strategjia e NVM-ve).

Si shumë vende të tjera të Evropës qendrore dhe lindore, Kosova ka qenë dhe ende është, duke u përballur me problem të tranzicionit në fushat e ekonomisë, sociale dhe ato politike. Kosova gjithashtu është duke kaluar nëpër procesin e disintegritetit të sistemit të vjetër ekonomik dhe disa vështirësive në tregti me partnerët rajonal, dhe nevojës në rritje të përshtatjes me ekonominë botërore dhe tregut konkurrues, që kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve për këtë aspekt në institucionet e nivelit lokal.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ndërmarrësisë, dhe me qëllim që të jemi sa më afër ndërmarrësve për të mbështetur ata, me asistencën e Komisionit

Evropian ne i kemi dhënë prioritet veprimeve në nivel regional dhe lokal. Në Kosovë kemi themeluar Asociacionin e Agjencive për Zhvillimin Rajonal (ARDA), i cili është një rrjet për zbatimin e politikave të Kosovës dhe BE-së dhe është një organizatë e pavarur, joqeveritare e themeluar në janar të vitit 2013 nga pesë Agjencitë Rajonale të Zhvillimit (Veri, Lindje, Perëndim, Jug dhe Qendër) në Kosovë. Misioni i ARDA-s është të koordinojë dhe promovojë zhvillimin rajonal dhe rural në Kosovë dhe të mbështesë pesë agjencitë e zhvillimit rajonal (AZHR-të) në marrjen e një roli udhëheqës në planifikimin dhe lehtësimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe rajonal të Kosovës. Një detyrë kryesore e ARDA-s është të lehtësojë partneritetin dhe bashkëpunimin midis qeverisë kombëtare dhe lokale, komunitetit të bizneseve dhe iniciativave të shoqërisë civile. Rrjeti i ARDA-s mbështetet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Në nivelin lokal, Komunitatet po e vënë theksin e tyre në zhvillimin fizik gjë që është plotësisht e kuptueshme pasi që bazat për shkallën e rritjes së biznesit dhe ndërmarrjeve të sektorit privat është ofrimi i një infrastrukture që është në gjendje t'i mundësojë biznesit të veprojë dhe të sigurojë një cilësi më të përshtatshme të jetës për bizneset, punëtorët dhe sigurisht për qytetarët në përgjithësi. Kur shtrohet pyetja si të ndihmohen më së miri komunitet, përgjigjja normale, jo e pa prituri, është furnizimi me financa shtesë për projektet kapitale. Në ditën e parë të këtij takimi me fjalë rasti janë prezentuar edhe znj.Suela Janina, ambasadore e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, z.Georg Ziegler nga Komisioni Evropian, z.Semir Efendiç, Kryetar i Qytetit të ri të Sarajevës, znj.Blerina Guga, Drejtore e Shoqatës së Këshillave Rajonal të Shqipërisë dhe z.Fuad Kasumoviç, Kryetar i qytetit të Zenicës.

Naim Ismajli - kryetar i AKK-së, flet në Bruksel për Zgjerimin e BE-së dhe rëndësinë e pushtetit lokal në këtë proces

Duke marrë pjesë në ditën e dytë të takimit të Komiteteve dhe Rajoneve të Evropës – në Grupin Punues për Ballkanin Perëndimor, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës u është adresuar të pranishmëve në temën: Zgjerimi i BE-së – Dinamika dhe Stabilizimi dhe rëndësia e pushtetit lokal në këto procese.

“Po flas këtu si Kryetar i Komunitetit dhe Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, por edhe si ish-President i NALAS-it. Disa javë më parë e kishim Asambleenë e Përgjithshme të NALAS-it dhe rolin e Presidentit të NALAS-it e dorëzova tek pasardhësi im Miko Micic nga Bijeljina. Të pranishëm në takim kishim edhe Dr. Schausberger i cili na përcjelli mesazhet e Komisionarit Hahn dhe vazhduam me një debat të hapur. NALAS-i ka zhvilluar një Dokument politik i cili elaboron të gjitha shqetësimet tona nga perspektiva e qeverisjes lokale në procesin e para aderimit si dhe me propozime konkrete për të optimizuar më tej mbështetjen e Komisionit Evropian në këtë proces.

• Për ilustrim, do të listoja disa propozime të ofruara nga Dokumenti ynë:

1. Propozimi për Komisionin Evropian që të krijoj një program për Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Autoriteteve Lokale për rajonin.

2. Një Fond Ndhimës për mbështetje për Vetëqeverisjen Lokale për të para-financuar projektet e financuara nga BE: a) të mbuloj mungesën e përkohshme të fondeve në procesin e zbatimit të projektit dhe b) të financoj kostot e papranueshme, të cilat janë të rëndësishme për të siguruar qëndrueshmërinë dhe integritetin e një projekti.

3. Për më tepër, duke marrë parasysh rrezikun e mundshëm të lëvizjeve të ndryshuara të emigracionit/refugjatëve (të kthyerit dhe integrimi) që prekin rajonin, NALAS-i rekomandon që të sigurohen lehtësira adekuate për qeveritë lokale në kuadër të lehtësirave të ndihmës humanitare dhe fatkeqësive të BE-së.

• Të gjitha këto mund të forcojnë stabilitetin në rajon dhe të sjellin prosperitet ekonomik.

• Për këtë qëllim presim që Komiteti i Rajoneve të marrë në konsideratë mesazhet që janë në Dokumentin politik të NALAS-it e që vijnë nga 12 Asociacione të Qeverisjes Lokale në rajon duke mbledhur mbi 9000 qeveri lokale dhe përfundimisht të paraqesë një rezolutë të CoR-së për Ballkanin Perëndimor.

• Përveç Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit, ReSPA dhe rrjetet e tjera të ministrive kombëtare, NALAS-i është i vetmi rrjet rajonal që bashkon të gjitha qeveritë lokale në rajon dhe si i tillë duhet të pra-



nohet plotësisht, inkurajohet dhe mbështetet nga DG NEAR.

• Si përfundim, mesazhet e mia kryesore janë që në të gjithë së bashku të punojmë rreth propozimeve në Dokumentin Politik të NALAS-it dhe t'i kërkojmë Komisionit të bëjë ndryshime në kuadrin e instrumenteve aktuale të para-pranimit.

• Komisioni i DG NEAR duhet të ketë një qasje të ngjashme ndaj qeverive lokale, siç ka BE-ja për shtetet e veta anëtare, të paktën kur bëhet fjalë për konsultimet në programim, buxhet dhe në zbatimin e programeve të reformës së shërbimit publik.

• Institucionet e BE-së duhet të kenë parasysh specifikat e autoriteteve lokale dhe rajonale si një nivel qeverisjeje dhe ata duhet të angazhohen me autoritetet lokale në dialogun e shumë akterëve për çështjet që lidhen me integrimin në BE dhe proceset e reformave. Duhet theksohet se qeveritë lokale dhe rajonale janë krijuesit e politikave si dhe ofruesit e shërbimeve sipas të drejtave dhe detyrimeve të përfshira në legjislacionin e tyre kombëtar.

• Ne besojmë fuqimisht se proceset e ndryshimit mund të jenë të qëndrueshme dhe të gjenerojnë ndikimin e dëshiruar nëse ato mbështeten nga niveli lokal e deri tek qytetarë të bindur, pro-aktiv dhe të përkushtuar në një aleancë strategjike me administratën publike dhe autoritetet që kanë të njëjtin vizion. Decentralizimi si një shtyllë e procesit të reformës demokratike është vendimtar për kohezionin social, stabilitetin dhe paqen në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për të ardhmen e Evropës.

• Nëse Evropa dëshiron të jetë afër qytetarëve të saj të ardhshëm, atëherë duhet të shikojë nga niveli lokal. BE-ja është afër njerëzve, për njerëzit dhe për reth njerëzve. Vendndodhja ku njerëzit jetojnë, veprojnë, takohen dhe të mbajnë lidhje direkte me qeverinë dhe administratën publike është niveli lokal! Për të qenë i suksesshëm, një qasje funksionale nga poshtë-lart varet nga një koordinim efektiv dhe bashkëpunim mes nivelit të qeverisjes lokale dhe qendrore” – tha ndër të tjera kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli.

Drejtori AKK-së priti përfaqësuesit e SDC-së

Një delegacion i SDC-së (Agjensioni Zvicerian për Zhvillim dhe Bashkëpunim) i përbërë nga z.Jean Michel Jordan – Menaxher i Programit të SDC-së në Bern, z.Patrick Etienne – Drejtor i Zyrës së SDC-së në Kosovë dhe znj.Saranda Cana – Zyrtare e Lartë e Programit të SDC-së në Kosovë u priten nga Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) z.Sazan Ibrahim. Në këtë takim z.Ibrahimi informoj delegacionin e SDC-së me angazhimet dhe arritjet e AKK-së në mbrojtjen e interesave të pushtetit lokal, ku u në këtë drejtim u vlerësua lartë kontributi dhe mbështetja që SDC i ka dhënë Asociacionit të Komunave të Kosovës ndër vite në forcimin dhe fuqizimin e AKK-së si një organizatë përfaqësuese e interesave të Komunave të Kosovës.



Poashtu në këtë takim u debatua edhe për bashkëpunimin mes Agjensioni Zvicerian për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në këtë fazë dhe në katër vitet e ardhshme ku u vlerësua se ky bashkëpunim dhe sidomos mbështetja që SDC-së po i jap AKK.

Në këtë drejtim u bisedua edhe për formën dhe mënyrën e koordinimit të veprimeve mes organizatave që merren me pushtetin lokal, në mënyrë që qeverisja lokale në Komunitat e Kosovës të shënoj progres në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët e tyre.

DISKUTIM MBI KONCEPT DOKUMENTIN PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj organizoi takimin e përbashkët të Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe atij të Shërbimeve Publike e ku mori pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ky takim u organizua me qëllim të diskutimit të propozim ndryshimeve në koncept dokumentin për Ndërmarrjet Publike. Diskutimi erdhi në vazhden e angazhimit për harmonizimin e



qëndrimeve të përbashkëta si dhe informimin e nevojshëm nga ana e zyrtarëve komunal për sfidat

dhe problematikat deritanishme në funksionimin e ndërmarrjeve publike komunale.

Takimi i përbashkët mes Kolegjiut për Arsim dhe Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës

Kolegjiut për Arsim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës organizoi takimin e përbashkët me Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës, ku u përfaqësua nga Kryesuesi z.Nait Hasani, ZëvendësKryesuesi z.Salih Morina dhe anëtarët znj.Shkuriye Bytyqi, z.Ismajl Kurteshi dhe znj.Teuta Haxhiu.



Në vlerësim të bashkëpunimit të shkëlqyeshëm me Komisionin Parlamentar në diskutimin e projektligjeve të ndryshme gjatë debateve publike, Kolegjiut për Arsim shprehu mirënjohjen për gatishmërinë e Komisionit në diskutimin e temave aktuale dhe ngritjen e problematikave me të cilat ballafaqohen autoritetet komunale në fushën e arsimit. Për më tepër anëtarët e Kolegjiut shprehën shqetësimin e tyre para anëtarëve të Komisionit duke u fokusuar veçanërisht në përplasjen e vendimeve nga institucionet e ndryshme sikurse është ai i

inspektorëve të punës dhe inspektorëve të arsimit, pushimet e lehonisë, pagat pas pensionimit të mësimitdhënësve, mësimitdhënësit me probleme shëndetësore si dhe udhëzimet dhe vendimet mbi programet e kolegjeve private.

Në anën tjetër, Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës ishte i vetëdijshëm në çështjen e konfliktit në mes udhëzimeve administrative të institucioneve të ndryshme në mos koordinimin e politikave institucionale, si njëra ndër nga rekomandimet drejtuar ministrive përkatëse. Duke ditur

se Komisioni Parlamentar ka në mandatin e saj shqyrtimin e projektligjeve të prezantuara nga Qeveria e Kosovës, anëtarët e Komisionit u shprehën të gatshëm dhe bashkëpunues për t'i marrë parasysh komentet dhe rekomandimet përkatëse dhe për të forcuar më tutje bashkëpunimin me AKK-në dhe Kolegjiutin e Arsimit në ngritjen e temave të ndryshme, shtyrjen përpara të proceseve në konsultim me Ministrinë e linjës në tejkalimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në fushën e arsimit si dhe diskutimin e tyre në Kuvendin e Kosovës.



U themelua Kolegjiumi për Prokurim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur takimim e parë themelues të 'Kolegjiumit për Prokurim' nga zyrtarët komunal për prokurim të komunave të Kosovës, në mbështetje nga projekti USAID - Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM). Duke pasur parasysh rëndësinë e Prokurimit Publik në komuna respektivisht rolin në rritje të zyrtarëve komunal të prokurimit, Bordi i AKK-së ka vendosur për themelimin dhe aktivizimin e Kolegjiumit të Udhëheqësve komunal të Prokurimit, në harmoni me objektivat e AKK-së për të avancuar e-qeverisjen në komuna. Për rëndësinë e tij dhe nevojat për themelimin e Kolegjiumit për Prokurim folën Gani Berisha nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, z. Agim Salihu nga projekti USAID si dhe Safet Hoxha kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Takimi fillestar kishte për qëllim, zgjedhjen e organeve drejtuese të tij, diskutimin për planin vjetor të



punës dhe çështje tjera që ndërlidhen me prokurim publik në Komunitat e Kosovës. Gjatë debatit nga përfaqësues komunal u vlerësua angazhimi dhe nevoja për funksionalizimin e këtij Kolegjiumi, në mënyrë që ata të jenë sa më produktiv dhe efikas në kryerjen e punëve, e cila shpie drejt transparencës, dhe kthimit të besimit të qytetarëve drejt institucioneve të prokurimit publik.

Takimi i Kolegjiumit për Buxhet e Financa

Njëra ndër kërkesat kryesore të adresuara të Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa mbetet përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe raportimit në mes Drejtorive Komunale për Buxhet e Financa dhe Departamentit për Buxhetet Komunale, Tatimit në Pronë dhe Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Poashtu edhe çështja e shkurtimeve buxhetore në kategoritë e ndryshme, andaj edhe diskutimi duhet të përqendrohet në alokimin e mjeteve shtesë, pra kërkohet koordinimi sa më i mirë që ka për synim të ofroj rekomandime se si të përmirësohet procesi në planifikimet dhe shpenzimet buxhetore komunale. Edhe përkundër mungesës së zyrtarëve të lartë nga Ministria e Financave në takim, Kolegjiumi diskutoi dhe paraqiti vështirësitë financiare në planifikimet buxhetore sikurse



janë: problemet serioze lidhur me nënkodet, rastet e lehonave, pagat jubilarë, ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesit etj.

Nga ky takim Kolegjiumi doli me porosi të qarta në adresimin e këtyre çështjeve sikurse është adresimi në Ministrinë e Financave i Kërkesës për Rishikimin e Buxhetit si nevojë urgjente në ecurinë dhe mbarëvajtjen e financave lokale. Po ashtu të merret parasysh edhe takimi informues me Komisionin e Granteve lidhur me problematikat aktuale dhe sugjerimet

në tejkalimin kësaj situatë. Ndërsa sa i përket procesit të tatimit në pronë nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) është shprehur gatishmëria që komunave tu mundësohet identifikimi përmes numrave personal si dhe shqyrtimi i mundësive me të dhëna shtesë drejt një sistemi efektiv të tatimit në prone si dhe shqyrtimi i trajnimeve të zyrtarëve komunal nga MF-ja në përcaktimin e formatit në nxjerrjen e raporteve sa i përket të hyrave të tatimit në pronë.

Shkurtimisht

- Përfaqësuesi i (AKK), mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, si anëtar në grupin punues për hartimin e “Koncept-dokumentit për Ligjin për tubime publike” dhe “Koncept-dokumentit për Ligjin për rend dhe qetësi”. Në këtë takim AKK dha kontributin e tij sa i përket ligjeve që i rregullojnë kompetencat e komunave në këto fusha që ishin temë diskutimi.
- AKK-ja ka organizuar punëtorinë tri ditore me Kryesinë e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor për hartimin e “Model-Rregullores për varreza dhe mirëmbajtjen e tyre”. Kjo ishte kërkesë e komunave, pasi ka mungesë të ligjit për këtë fushë kurse me anë të kësaj Rregullore do të plotësohet vakumi ligjor në nivelin lokal.
- AKK-ja ka pranuar nga Ministria e Drejtësisë, “Koncept Dokumentin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore”, për konsultime paraprake, të cilin dokument e shqyrton me Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjor.
- Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në punëtorinë tri ditore të organizuar nga MAPL-ja, për shqyrtimin e “Projekt-Udhëzimi Administrativ për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave”.
- Përfaqësuesit e AKK-së, morën pjesë në takimin e organizuar nga UNDP-për mundësinë e bashkëpunimit për projektin SEE – URBAN (Ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën Juglindore. Ky projekt pritet të implementohet nga UNDP, AKK dhe AME (Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave).
- AKK-ja ishte bashkë organizatore me NDP-në dhe AME-në (Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave) e tryezës e rrumbullakët të projektit rajonal “Ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën juglindore”. Me këtë rast përfaqësuesi i AKK-së prezantoi modelin për rrjetëzimin e komunave të Kosovës për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë.
- Përfaqësuesi i AKK-së është emëruar me vendim të MPB-së, anëtar në Grupin Punues për hartimin e “Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Planin e veprimit 2018-2022”.
- Përfaqësuesi i AKK-së është anëtar i Komitetit Drejtues, në projektin SitAn të menaxhuar nga zyra e UNICEF-it në Kosovë.

Komuna e Ferizajit fiton turnirin në futboll mes Komunave të Kosovës

Me rastin e shënimit të përvjetorit të 16 të themelimit të Asociacioni i Komunave të Kosovës, u mbajt turniri në futboll të vogël me datën 30 qershor 2017.

Në këtë turne morën pjesë 18 Komuna me ekipet e tyre dhe ekipi nga Zyra e AKK-së.

Vendin e parë e fitoi Komuna e Ferizajit të cilët mundën në finale Ekipin nga Zyra e AKK-së me rezultat 2:1.

Komuna e Ferizajit u nderua me një trofe dhe fanela sportive.

Në shënim të themelimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, 16 vite më pas, Asociacioni i Komunave falënderon komunitat dhe bashkëpunëtorët e partnerët e tij për këtë rrugëtim të përbashkët.



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XIV. Nr. 84 • Maj - Qershor 2017

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

